




RAPORTI I PESTË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN



KUVENDI NËN THJERRËZ

Përforcimi i debatit politik
dhe diskursit deliberativ

DHJETOR 2014



RAPORTI I PESTË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN (DHJETOR)

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik. Para jush është raporti i dytë i cili ka të bëjë me raportimin e 10 medieve kombëtare në periudhën nga 1 – 30 nëntor i vitit 2014.

Me aplikimin e “Indeksit për cilësi të debatit”¹ sipas disa parametrave vlerësohet çdo fjalim veç-e-veç i pjesëmarrësve në seancat plenare dhe seancat e tetë komisione kuvendore të përzgjedhura sipas domethënies së tyre për debatin politik dhe për kulturën politike në shtetin.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike, të fitohen njohuri se sa janë të argumentuara diskutimet në shtëpinë ligjvënëse dhe se sa qëndrimet e ndryshme merren parasysh dhe kontribuojnë në krijimin e ligjeve.

A. REZYME

Në të njëjtën kohë, në kuadër të projektit realizohet edhe monitorimi i disa medimeve kombëtare² për tu parë se në çfarë mase opinioni është i njoftuar me esencën e debateve kuvendore dhe me përmbajtjen e argumenteve të shfaqura në seancat nga ana e deputetëve.

Pas çdo muaji të monitoruar opinioni do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe nga monitorimi i debatit në Kuvendin dhe të informimit media nga puna e parlamentit.

¹ Indeksi për cilësi të debatit (Discourse Quality Index) është i krijuar nga një grup i teoricienëve prijës botëror demokracisë deliberative (debatuese). Indeksi paraqet metodologji e cila mundëson hulumtim empirik të cilësisë së debateve, forma dhe përmbajtja e të cilave, sipas teoricienëve, janë jashtëzakonisht të rëndësishme për demokracinë në një shoqëri. Indeksi gjatë viteve të fundit është përdorur për hulumtim të debatit në Parlamentin Evropian edhe në parlamentet e Gjermanisë, Zvicrës dhe në Kongresin amerikan.

² Monitorimi i medieve i përfshin televizionet kombëtare Sitel, Tellma, Alsat-M dhe RTM2 në gjuhën shqipe dhe gazetatat Dnevnik, Silloboden pečat, Utrinski vesnik, Večer, Koha dhe Lajm.



Deputetët në dhjetor e shtuan interaksionin, por sërish nuk arritën të ç'binden në vlefshmërinë e argumenteve të veta dhe çdokush mbeti në "istikamin" e vet.

Gjetjet kyçe në Raportin e Pestë të monitorimit (periudha e vëzhgimit 1-31 dhjetor, gjithsej 11 seanca kuvendore) janë se diskutimi rreth propozimeve ligjore mbetet i dobët, me një interaksion diç më të madh midis deputetëve krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara (19 qershor – 1 gusht, 25 gusht -30 shtator dhe nëntor 2014). Interaksioni i shtuar pasqyrohet në rritjen e replikave posaçërisht për disa tema: pyetjet të deputetëve dhe ndryshimet e ligjeve për arsimin e lartë, për planifikim urbanistik dhe hapësinor dhe për nëpunës administrativ.

Pjesëmarrësit në seancat e monitoruara sërish nuk shfaqën interes dhe gatishmëri për ndryshimin e qëndrimeve për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara në debatin duke e pasur parasysh se asnjë deputet nuk ka vënë në pah ndryshimin e pozicionit të vet. Në pjesë më të madhe folësit as që i kanë vështruar argumentet e paraprirësve të vet.

Deputetët më së paku deri tani, që nga fillimi i monitorimit, deputetët thirren se argumentet e tyre janë në favor të të mirës së përgjithshme, ndërsa njëkohësisht deri tani janë thirrur në parime abstrakte.

Opozita në dhjetor e rriti pjesëmarrjen në diskutimet në raport me muajin paraprak dhe arriti 21%. Kjo është e njëjtë me pjesëmarrjen opozitare në diskutimet në tetor, e njëkohësisht ky është niveli më i lartë i shënuar në seancat e monitoruar deri tani.

Deputetët në pjesën më të madhe të diskutimeve gjatë arsyetimit të pozitive të veta shfrytëzonin dy dhe më tepër argumente. Me këtë rast, krahasuar me muajt paraprak u rrit përqindja e diskutimeve me një argument, ndërsa u zvogëluar numri i diskutimeve në të cilat nuk janë prezantuar argumente.

Pjesa më e madhe e pikave të rendit të ditës kaluan me diskutim të pakët ose të njëanshëm madhe edhe pa kurrfarë diskutimi.

Me këtë opinionin sërish mbeti i varfëruar për debat cilësor për një pjesë të zgjidhjeve ligjore. Kështu është lëshuar mundësia që përmes diskutimit të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të prezantuara dhe mundësia që ato të kontestohen ose të plotësuara gjë e cila do të kontribuonte për sjellje të vendimeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.

B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

"Indeksi i cilësisë së debatit" mundëson që çdo debat i veçantë i shfaqur në seancat të kodifikohet sipas disa karakteristikave kryesore:



- shkalla e argumentimit të fjalimit³;
- shkalla i respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- çiltërsia për praninë të argumenteve të huaja dhe ndryshim të qëndrimeve të veta nën fuqinë e argumenteve të prezantuara në debatin;
- nëse deputetët arsyetojnë se në emër të kujt dhe interesat e kujt i prezantojnë qëndrimet e veta;
- nëse deputetët mund pa pengesa ti shfaqin qëndrimet e veta dhe
- në çfarë mase është i pranishëm fjalori i pahijshëm.

Me monitorimin janë përfshirë debatet në trupat vijuese punuese në Kuvend:

- Seanca plenare;
- Komisioni për çështje kushtetuese;
- Komisioni për financa dhe buxhet;
- Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive;
- Komisioni për zgjedhje dhe emërimet;
- Komisioni për vetëqeverisje lokale;
- Komisioni për çështje evropiane;
- Komisioni anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit;
- Komisioni ligjvënës juridik.

V. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill 2014, partia Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (OBMR-PDUK ose VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin ata e themeluan qeverinë, Bashkimi demokratik për integrim (BDI ose DUI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë të Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (NDP). Deputeti i cili mandatin e fitoi nga RDK edhe përkundër vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin ju bashkëngjiti grupit parlamentar të BDI. Me atë grupi i deputetëve i BDI numëron 20 deputetë.

³Nën shkallë të argumentimit merren parasysh numri i argumenteve me të cilat deputeti në fjalimin e tij i arsyeton pozicionet e veta duke mos hyrë me këtë rast në vërtetësinë ose vlefshmërinë e argumenteve. Me këtë rast nuk merren parasysh argumentet të cilat në mënyrë të qartë dhe pa dyshim janë nga tema e debatit.




Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e raportit të parë, deputetët nga koalicioni më i madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM ose SDSM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotojnë punën e Kuvendit⁴. Në muajin dhjetor në Kuvend si opozitarë vepronin tre deputetët e koalicionit opozitar të LSDM të cilët vendosën që ti pranojnë mandatet dhe shtatë deputetë të Partisë demokratike shqiptare (PDSH). Shumica në Kuvendin në dhjetor e vazhdoi procedurën për marrje të mandateve për 31 deputet opozitar të cilët e bojkotojnë parlamentin. Procedura nuk ka përfunduar duke pasur parasysh se votimi për marrje të mandateve për deputetët opozitar që mungojnë i caktuar për seancën e 26 dhjetorit u shty për shkak se partitë në pushtet nuk siguruan shumicë prej dy të treta të deputetëve, përkatësisht 82 deputetë votat e të cilëve janë të nevojshme për votimin e vendimit të tillë.

G. GJETJE NGA MONITORIMI

Ky raport e përfshin debatin në Kuvend në periudhën nga 1 deri më 31 dhjetor. Janë analizuar gjithsej 396 fjalime të pjesëmarrësve të debateve në gjithsej 11 seanca nga të cilat 7 janë plenare dhe 4 janë të trupave punuese. Nga seancat e trupave punuese janë përcjellë dy seanca të Komisionit për sistem politik dhe raporte midis bashkësive dhe nga një të Komisionit ligdhënës-juridik dhe Komisioni për zgjedhje dhe emërimë.

Nga numri i tërësishëm i fjalimeve të monitoruara, 288 janë të deputetëve në Kuvendin, ndërsa 108 të pjesëmarrësve të jashtëm si ministra, përfaqësues të ministrive, institucione të tjera shtetërore dhe publike, organizata civile dhe ekspertë. Në 11 seanca pjesëmarrësit në diskutimet janë shprehur për gjithsej 81 pikë të rendit të ditës. Ky raport ka të bëjë vetëm me fjalimet e deputetëve.




Në raport me karakteristikat demografike të folësve, sipas:

- Seksi: 50% janë burra, ndërsa 50% gra.


⁴Deputetët opozitare Roza Topuzovska Karevska nga Partia Liberale demokratike, Sollza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhje edhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.





- Përkatësia etnike: 89% janë Maqedonas etnik, 8% Shqiptarë etnik, 3% janë të tjerë.
- Arsिमimi: 67% janë me arsim të lartë, 22% magjistra 11% doktorë të shkencave.
- Në tetor më aktiv ishin deputetët nga njësia e pestë zgjedhore, ndërsa më pak diskutime kishin deputetët e njësisë së parë zgjedhore.




Në dhjetor deputetët opozitar e rritën pjesëmarrjen në diskutimet në 21% që është më tepër në raport me nëntorin. Kjo përqindje e pjesëmarrjes është identike si në muajin tetor dhe njëkohësisht është pjesëmarrja më e lartë e arritur e opozitës në diskutimet që nga fillimi i monitorimit.



Në seancat e monitoruara të cilat u mbajtën në dhjetor në deputetët burra dhe gra shkon përqindje e njëjtë e diskutimeve - 50%. Mirëpo, nëse merret parasysh se deputetët gra janë 35% nga numri i tërësishëm i deputetëve në përbërjen aktuale të Kuvendit rezultojnë se gratë më shpesh e kanë marrë fjalën se sa burrat.



Sipas pjesëmarrjes, nëse koha e tërësishme e diskutimeve ndahet në numrin e tërësishëm të mandateve të pranura nga deputetët rezulton se mesatarisht çdo deputet nga shumica ka folur nga 11, ndërsa nga opozita nga 18 minuta. Nëse koha e tërësishme ndahet vetëm në deputetët të cilët kanë marrë fjalë rezulton se çdo fjalim i paraqitur nga deputetët opozitar dhe nga deputetët e shumicës mesatarisht ka zgjatur nga 4 minuta.




I. LLOJ I FJALIMIT DHE INTERAKSIONI

Monitorimi në dhjetor krahas seancave të rregullta dhe seancave të trupave punues përfshiu një seancë plenare të kushtuar pyetjeve të deputetëve dhe një seancë të komisionit në të cilën u mbajt




debat publik në të cilin pjesa më e madhe e pjesëmarrësve nuk ishin deputetë në Kuvendin, por anëtarë të jashtëm midis të cilëve ekspertë dhe përfaqësues të pushtetit gjyqësor dhe të atij ekzekutiv.

Monitorimi në dhjetor tregoi rritje të interaksionit midis deputetëve shikuar përmes numrit të replikave dhe kundër-replikave midis pjesëmarrësve në diskutimet krahasuar me muajin paraprak. Me këtë rast, si replika dhe kundër-replika janë shënuar edhe pyetjet dhe përgjigjet midis deputetëve dhe ministrave në seancën plenare të kushtuar pyetjeve të deputetëve. Në seancat individuale në diskutime individuale shkojnë 65%, në replika 17%, ndërsa në kundër-replika 18% nga diskutimet. Kjo tregon se deputetët për 10% më shpesh u janë përgjigjur diskutimeve të pjesëmarrësve në debat krahasuar me nëntorin, ndërsa kundër-replikat janë shtuar për 6%. Nëse shihet e tërë periudha nga fillimi i monitorimit kjo është përqindja më e lartë e kundër-replikave, ndërsa përqindja e replikave ka qenë më e lartë vetëm në tetor. Në dhjetor deputetët krahas seancës të kushtuar pyetjeve të deputetëve, më shumë diskutim zhvilluan rreth ndryshimeve të Ligjit për arsim të lartë, Propozim – ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik dhe ndryshimet e Ligjit për nëpunës administrativ.




Në dhjetor në seancat e monitoruara deputetët burra kanë dhënë 55% nga fjalimet individuale, 52% nga replikat dhe 28% nga kundër-replikat. Deputetët gra, ndërkaq, kanë dhënë 45% nga fjalimet individuale, 48% nga replikat dhe 72% nga kundër-replikat.





II. SHKALLË E ARGUMENTIMIT TË FJALIMIT

Nga fjalimet e monitoruara të deputetëve sipas Indeksit për cilësi të debatit, në 63% ekziston arsytim të pozicioneve me dy ose më tepër se dy argumente. Në 29% të fjalimeve deputetët i kanë arsyetuar pozitat e veta me një argument. Në 6% argumentimi ka qenë i dobët, përkatësisht arsytimi që e ka dhënë diskutuesi nuk ka mjaftuar që të konsiderohet argument i plotë. Në 2% nuk është prezantuar kurrfarë argumenti në diskutimin. Marrë në përgjithësi, në dhjetor shkalla e argumentimit me më së paku dy argumente është diçka më e lartë se sa në tetor dhe nëntor, por më e ulët sesa në dy periudhat e para të monitorimit (19 qershor – 1 gusht dhe 25 gusht – 30 shtator). Diskutimet në të cilat deputetët në fjalimet e veta kanë përdorur një argument në dhjetor arriti 29% që është shkallë më e lartë që nga fillimi i monitorimit. Në llogari të kësaj përqindja e diskutimeve pa argumente ka rënë në 2% që është më e lartë deri tani.




III. FUQIA E ARGUMENTIT MË TË MIRË

Në seancat e monitoruara në dhjetor si dhe në tre periudhat paraprake, asnjë diskutues nuk ka vënë në pah se e ndryshon pozitën e vet për shkak të argumenteve më të mira të prezantuara në debatin, ose për shkaqe të tjera. Ndryshimi i tillë i pozitës është vërejtur vetëm në periudhën e parë të monitoruar (19 qershor – 1 gusht). Krahasuar me nëntorin, për 16% janë zvogëluar diskutimet në të cilat deputetët aspak nuk i vështrojnë argumentet e prezantuara nga pjesëmarrësit e tjerë. Mirëpo, kjo përqindje ende është në të lartat 83% gjë e cila është më tepër se sa në tre periudhat e monitoruara 19 qershor – 1 gusht, 25 gusht - 30 shtator dhe tetor. Në dhjetor mbresëlënëse është se në seancat e monitoruara në 14% të diskutimeve diskutuesit nuk e kanë ndryshuar pozicionin e vet, ndërsa njëkohësisht edhe nuk e kanë pranuar vlefshmërinë e argumenteve të prezantuara nga diskutuesit e tjerë. Vetëm në 3% folësit nuk e kanë ndryshuar pozicionin, por e kanë pranuar vlerën e argumenteve të huaja.



IV. RESPEKTIM NDAJ PJESËMARRËSIT


Deputetët në dhjetor në kuadër të fjalimeve të veta, në pjesë më të madhe, përkatësisht në 62% të diskutimeve nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj pjesëmarrësve të tjerë në seancat. Ajo është për 8% më tepër nga nëntori dhe vazhdimi i trendit të rritjes së vazhdueshme të kësaj përqindjeje nga fillimi i monitorimit në qershor. Gjithashtu edhe në dhjetor vazhdoi trendi i dytë përkatësisht zvogëlimi i diskutimeve në të cilat folësit shfaqin respektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë në debatet. Ashtu kjo përqindje në dhjetor është 28% që është më e ulët deri tani që nga fillimi i monitorimit. Nuk është vërejtur rast që të shfaqet mos-respektim i plotë ndaj pjesëmarrësve të tjerë. Në dhjetor në 9% të diskutimeve është vërejtur respektim i pjesshëm që do të thotë se folësi në pjesë më të madhe të fjalimit të vet ka qenë neutral, ose ka shfaqur respektim, por në pjesë më të vogël ka shfaqur mos-respektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë.






V. RESPEKTIM NDAJ ARGUMENTEVE

Deputetët në seancat e monitoruara në dhjetor më shumë deri tani krahasuar me periudhat paraprake të monitoruara kanë qenë të disponuar të shfaqin respektim ndaj argumenteve të diskutuesve të tjerë. Kjo ka ndodhur në 8% të diskutimeve të tyre për dallim të 17% në nëntor, 16% në periudhën nga 25 gushti – 30 shtator dhe 74% nga 19 qershori – 1 gusht. Për llogari të kësaj sërish u rrit përqindja e diskutimeve në të cilat folësit nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj argumenteve të folësve të tjerë dhe arriti 85%, që është më shumë deri tani. Në 8% të diskutimeve diskutuesit kanë shfaqur respektim të pjesshëm. Kjo do të thotë se deputetët në fjalimet ndaj argumenteve të të tjerëve në pjesë më të madhe kanë qenë neutral ose kanë shfaqur respektim, ndërsa në pjesën më të vogël kanë shfaqur mos-respektim ndaj argumenteve të kolegëve të vet.



VI. VËLLIMI I ARSYETIMEVE DHE TË NDËRPRERJEVE

Në debatet parlamentare në dhjetor në 34% të fjalimeve, pjesëmarrësit janë thirrur në atë se pozicionet dhe qëndrimet e tyre janë në drejtim të të mirës së përgjithshme dhe të interesave të të gjithë qytetarëve. Ky është zvogëlim për 11% të drejtimit të tillë nga diskutuesit duke pasur parasysh atë se në të mirën e përgjithshme janë thirrur në 45% të diskutimeve. Në dy periudhat e para të monitoruara (19 qershor – 1 gusht dhe 25 gusht – 30 shtator) deputetët thirren në të mirën e përgjithshme në madje 88% të diskutimeve. Në dhjetor folësit në 23% të diskutimeve janë thirrur në parime abstrakte si drejtësi sociale, paqe, barazi, cilësi e të jetuarit dhe ngjashëm që është përqindja më e lartë deri tani që nga fillimi i monitorimit. Në përfitimet ose pasojat për grupin vetanak (etnik, politik, fetar, profesional) folësit janë thirrur në 29% të diskutimeve gjë e cila është zvogëlim për 10% krahasuar me nëntorin, por prapëseprapë në mënyrë të dukshme më tepër se sa në tetor dhe në periudhat 19 qershor – 1 gusht dhe 25 gusht – 30 shtator. Në 11% të diskutimeve folësit kanë qenë neutral përkatësisht nuk janë thirrur në asgjë gjatë prezantimit të argumenteve.



VII. GJUHA E PAHIJSHME

Në pikëpamje të gjuhës së pahijshme, pjesëmarrësit në debatet e monitoruara kuvendore në këtë periudhë, në përgjithësi janë përmbajtur nga përdorimi i saj. Në dhjetor në seancat e monitoruara nuk është vërejtur folës të ketë përdorur gjuhë të pahijshme, e as është vërejtur rast i kufizimit të deputetëve gjatë fjalimeve të tyre nga folësit e tjerë.

D. KONKLUZIONE:

- Pjesëmarrësit në seancat e monitoruara sërish nuk shfaqën interes dhe gatishmëri për ndryshim të qëndrimeve për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara në debatin duke e pasur parasysh se asnjë deputet nuk ka vënë në pah se e ndryshon pozicionin. Njëkohësisht, mbetet e lartë përqindja e diskutimeve në të cilat folësit nuk u bëjnë vështrim argumenteve të shfaqura nga folës të tjerë. Në rastet kur folësit u kanë bërë vështrim argumenteve të kolegëve, më shpesh nuk e kanë pranuar vlefshmërinë e tyre.
- Pyetjet e deputetëve dhe ndryshimet e ligjeve për arsim të lartë, për rregullim hapësinor dhe urbanistik dhe për nëpunës administrativ nxiti debat midis deputetëve gjë e cila u pasqyrua në numrin e shtuar të replikave midis pjesëmarrësve në seancat krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara (nëntor, periudhat 25 gusht - 30 shtator dhe 19 qershor – 1 gusht). Më tepër replika ka pasur vetëm në tetor ndërsa në dhjetor deputetët kanë pasur më shumë kundër-replika deri tani.
- Deputetët opozitar ishin më aktiv krahasuar me muajin e kaluar (nëntor) dhe sërish e arritën nivelin më të lartë të pjesëmarrjes deri tani prej 21% e cila u vërejt edhe në tetor.



- Sipas seksit të deputetëve edhe te burrat edhe te gratë shkojnë nga 50% të numrit të tërësishëm të diskutimeve. Prej tyre burrat kanë pasur më tepër diskutime dhe replika individuale, ndërsa te gratë shkon pjesa më e madhe e kundër-replikave.
- Diskutimi rreth pjesës më të madhe të propozimeve ligjore mbetet në përgjithësi i dobët dhe nuk mundëson që përmes debatit publik të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të përgatitura dhe të prezantuara nga deputetët. Me atë lëshohet mundësia që argumentet të kontestohen ose të plotësohen, e me atë opinioni është i varfëruar për pikëpamje të ndryshme të cilat do të kontribuonin për përpilim të vendimeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.
- Pjesa më e madhe të fjalimeve të analizuar në periudhën e monitoruar, janë të përkrahura me dy dhe më tepër argumente. Në dhjetor është rritur përqindja e fjalimeve të përkrahura me një argument, ndërsa është zvogëluar përqindja e fjalimeve në të cilat deputetët nuk kanë prezantuar kurrfarë argumente.
- Është zvogëluar përqindja e diskutimeve në të cilat folësit janë thirrur në atë se argumentet e tyre shkojnë në favor të përfitimeve ose pasojave për të mirën e përgjithshme. Për llogari të asaj, është rritur përqindja e diskutimeve në të cilat folësit janë thirrur në parime abstrakte, ndërsa gjithashtu edhe të diskutimeve në të cilat folësit kanë mbetur neutral.
- Në dhjetor në seancat e monitoruara nuk është vërejtur përdorim i fjalimit të pahijshëm, e as ndërprerje ose vënie në pah nga ndonjë deputet se është i kufizuar në mundësinë që ta shpreh mendimin e vet.

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit publik dhe diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian.